



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 16

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 15 korrik 2015, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Adem Hoxha, Shukrije Bytyçi dhe Bekim Haxhiu.

Mungoi: Njomza Emini.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 30.06.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.06.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.06.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor;

Kryetarja – konstatoj që grupi punues ka përfunduar amendamentimin e Projektligjit dhe tani Komisioni do ti votoj amendamentet e propozuara nga grupi punues si vijon :

Amendamenti 1

Në nenin 1, fshihet fjalia “vendosjen e rregullativave bazike në shëndetin mendor,”.

Amendamenti 2

Në nenin 2, fshihet fjalia “Ky ligj zbatohet nga/ndaj personat/personave, fizik dhe juridik, vendas ose të huaj, me vendbanim/vendqëndrim në Republikën e Kosovës.”

Amendamenti 3

Në nenin 3 paragrafin, 1 shprehja “udhëzim administrativ” zëvendësohet me fjalën “ligj”.

Amendamenti 4

Në nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. fshihet, kurse nën-paragrafi 1.12. bartet si nën-paragraf 1.1. si vijon:

1.1. **Shëndet mendor:** Shëndeti mendor përcaktohet si gjendje e mirëqenies në të cilin individ realizon potencialin e tij/saj, mund të përballë me streset normale të jetës, mundet të punoj me produktivitet dhe të jap kontribut për vetën dhe komunitetin;

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.13. shprehja “aktorëve” zëvendësohet me fjalën “akterve”.

Amendamenti 6

Në nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.17, riformulohet si vijon:

1.17. **Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)** - organizatë e pavarur shëndetësore me rëndësi të veçantë publike në nivelin e kujdesit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, me cilësi të personit juridik, që ka të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi.

Amendamenti 7

Në nenin 3 paragrafin 1, pas nëparagrafit 1.17. shtohet një nën-paragraf i ri si vijon:

Komisioni psikiatrik–ligjor, është komision profesional i cili jep vlerësimin për gjendjen mendore të klientit-pacientit.

Amendamenti 8

Në nenin 5, paragrafin 1, nën-paragrafi 1.3, riformulohet si vijon:

1.3. Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore.

Amendamenti 9

Në nenin 5, paragrafin 1, në fund të nën-paragrafit 1.5, shtohet teksti “të aplikuar në Kosovë”.

Amendamenti 10

Në nenin 11, paragrafin 1, teksti “personeli infermieror” zëvendësohet me tekstin “shërbim i infermierisë”.

Amendamenti 11

Neni 13, paragrafin 1, riformulohet si vijon:

1. Shërbimet e shëndetit mendor të nivelit tretësor ofrohen në SHSKUK dhe atë në:

- 1.1. Klinikën e psikiatrisë;
- 1.2. Institucionin përkatës të Psikiatrisë Forenzike;
- 1.3. Institucionin përkatës të Sëmundjeve të Varësisë.

Amendamenti 12

Në emërtimin e nenit 14, dhe paragrafin 1 të këtij neni fshihet fjala “dhe adoleshent”.

Amendamenti 13

Në nenin 14, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri si vijon:

3. Opinion i fëmijës duhet të merret parasysh në rastet e trajtimit të pavullnetshëm dhe vendosjes së pavullnetshme në përputhje me moshën dhe pjekurin e fëmijës”.

Amendamenti 14

Në nenin 15, paragrafin 2, teksti “asociacionet profesionale të vendit” zëvendësohet me tekstin “Odat e profesionistëve shëndetësor”.

Amendamenti 15

Neni 16, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës garanton mbështetjen psikologjike, psiko-pedagogjike, shërbimet e ndihmës personale ose familjare, si dhe mbështetje financiare përmes skemave të

parapara me dispozitat ligjore për personat me aftësi të kufizuara apo personat me çrregullime mendore.

Amendamenti 16

Në nenin 16, paragrafin 3, fjala “vendore” zëvendësohet me fjalën “lokal”.

Amendamenti 17

Në nenin 18, në fund të paragrafit 2, shtohet teksti si vijon: “,të miratuar nga Qeveria”.

Amendamenti 18

Neni 19, paragrafi 1, riformulohet dhe ndahet në dy paragraf, si vijon:

1. Personi me çrregullime mendore merr trajtim të vullnetshëm në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kusht të informimit paraprak.

2. Miratimin për të miturit ose personat me zotësi të kufizuar për të vepruar e jep kujdestari ose përfaqësuesi i tyre ligjor. Në rastet kur i mituri ose personi me zotësi të kufizuar është në gjendje të shpreh mendimin e tij/saj, dhe megjithatë i është nënshtruar trajtimit me kërkesë të kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të tij/saj, ai ka të drejtë të ankohe ndaj një vendimi të tillë pranë gjykatës me përfaqësim të pavarur.

Amendamenti 19

Në nenin 19, në fund të paragrafit 5, shtohet teksti si vijon: ”në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale”.

Amendamenti 20

Neni 20, fjalia në fund të paragrafit 1, ndahet si nën-paragraf 1.1, i paragrafit 1, si vijon:

1.1. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja dhe mandati i Komisionit të mjekëve specialist, do të rregullohet me akt nënligjore të cilin e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë.

Amendamenti 21

Në nenin 20, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.3, fjalia “kufizuese” zëvendësohet me fjalinë “shtrënguese”.

Amendamenti 22

Në nenin 20 pas nënparagrafit 2.3, shtohen dy nën-paragrafët si në vijim:

2.4. Opinioni i personit të prekur është marre parasysh.

2.5. Nuk ka në dispozicion masa me pak ndërhyrëse të ofrimit të kujdesit të duhur.

Amendamenti 23

Në nenin 20, paragrafin 3, fshihet fjala “personalisht”, kurse fjalia “Person i sëmurë” zëvendësohet me fjalinë “personi me çrregullime mendore”.

Amendamenti 24

Në nenin 21, pas nënparagrafit 1.5. shtohet një nën-paragraf si në vijim:

1.6. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare duke përfshirë edhe privatësinë e komunikimit dhe korrespondencës.

Amendamenti 25

Në nenin 23, në paragrafin 2 dhe 3, fshihet fjalia “kanë rënë shkaqet”.

Amendamenti 26

Në nenin 23, paragrafin 4, fjalia “nuk kanë rënë shkaqet” zëvendësohet me fjalinë “ekzistojnë shkaqet”.

Amendamenti 27

Në nenin 25, fjalia në fund të paragrafit 2, ndahet si paragraf 3, si vijon:

3. Terapia elektrokonvulsive nuk zbatohet tek fëmijët.

Amendamenti 28

Në nenin 26 , paragrafi 2 fshihet.

Amendamenti 29

Neni 27, paragrafi 6, riformulohet si vijon:

6. Klienti / familjari, përfaqësuesi ligjorë ose institucioni shtetëror përkatës, duhet të informohet brenda dyzetë e tetë (48) ore, kur klienti është apo bëhet subjekt i kufizimit fizik.

Amendamenti 30

Neni 28, paragrafi 1, fshihet fjala “një”.

Amendamenti 31

Neni 28, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, shndërrohen në paragraf 2,3, dhe 4.

Amendamenti 32

Neni 28, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, i cili shëndërrohet si paragraf 4, riformulohet si vijon:

4. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë i propozojnë Qeverisë për miratim aktin nënligjor ku i përcaktojnë rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve të shëndetit mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Amendamenti 33

Në nenin 29, paragrafin 1, fshihet fjalia e dytë “Përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtij këshilli miratohet me vendim të Qeverisë me propozimin e ministrit të Shëndetësisë” dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim: “Fushëveprimi, kompetencat, përbërja si dhe mandati i Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor, përcaktohet me akt nënligjor të cilin e propozon Ministria e Shëndetësisë dhe e miraton Qeveria”.

Amendamenti 34

Në nenin 32, paragrafi 1, pas fjalës “detyruar” shtohet fjalia “që brenda afatit pesëmbëdhjete (15) ditë punë”.

Amendamenti 35

Neni 32, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Pala e interesuara ka të drejtë të parashtrojë ankesë kundër vendimit të institucioneve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në Ministrinë e Shëndetësisë brenda afatit pesëmbëdhjete (15) ditë punë. Ministria e Shëndetësisë duhet ti përgjigjet palës në ankesën e saj brenda afatit tridhjetë (30) ditë punë.

Amendamenti 36

Në nenin 32, paragrafi 3, fjalia “Ministrit të Shëndetësisë” zëvendësohet me “Ministrisë së Shëndetësisë”.

Amendamenti 37

Emërtimi i nenit 33 “**Sanksionet Administrative**” zëvendësohet me tekstin “**Dispozitat ndëshkuese**” .

Amendamenti 38

Në nenin 33, paragrafin 1, fshihet teksti “neneve të mëposhtme” zëvendësohet me tekstin “shkelja e dispozitave të këtij ligji”.

Amendamenti 39

Në nenin 33, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6. në fund të nën-paragrafit shtohet fjalia,, 1.000 €; si dhe në nën-paragrafin 1.7 fshihet teksti “ që marrin trajtim të pavullnetshëm”.

Amendamenti 40

Në nenin 33, paragrafin 2, para 1.6. shtohet 1.7. si dhe në paragrafin 3, pas 1.1. shtohet 1.6.

Amendamenti 41

Neni 34, riformulohet si vijon:

1. Për zbatimin e këtij ligji, në afat brenda një (1) viti, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministritë përkatëse nxjerrin aktet përkatëse nënligjore të cilat parashihen me këtë ligj.
2. Aktet nënligjore që janë të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Amendamenti 42

Neni 35, riformulohet si vijon:

Neni 35 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Te gjitha amendamentet e propozuara nga grupi punues u votuan njëzëri nga anëtarët e Komisionit përveç amendamentit 11, ku deputetja Besa Baftiu votoi kundër këtij amendamenti, me arsyetimin se Institucionin përkatës i Psikiatrisë Forenzike, duhet të quhet Instituti i Psikiatrisë Forenzike.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri votoj amendamente e propozuara dhe i procedoj për shqyrtim nga Komisionet kryesore.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;

Kryetarja – konstatoj që edhe për këtë projektligj grupi punues ka përfunduar amendamentimin dhe tani Komisioni do të votojë amendamentet e propozuara nga grupi punues, por fillimisht i kaloj fjalën deputetit Bekim Haxhiu i cili ka parashtruar 5 amendamente në këtë Projektligj dhe e ftojme të arsyetojë para Komisionit amendamente e propozuara.

Bekim Haxhiu – Qellim i këtyre amendamenteve është të stimulohet ushqyshmëria me qumësht gjiri dhe për të krijuar kushte më të mira për femra që janë në gjidhënje.

Kryetarja – Vazhdojmë me votimin e amendamenteve si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, të ndahet në dy paragrafë dhe paragrafi 2, të riformulohet si vijon :

Ky ligj është përafruar me Direktivën e Komisionit 2006/141 të datës. 22 dhjetor 2006 mbi formulën qumështore dhe formulën pasuese që amendamenton Direktivën 1999/21/EC si dhe me Rregulloren (EU) Nr. 609/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 12 qershor 2013 mbi ushqimin e destinuar për foshnjat dhe fëmijët e rinj, ushqimin për përdorime të veçanta mjekësore dhe zëvendësimin e plotë dietal për kontrollin e peshës.

Amendamenti 2

Në nenin 3, paragrafi 1.3. fjala „ **Commission** “ zëvendësohet me „**Komision** “

Amendamenti 3

Në nenin 3, paragrafi 1.11 dhe 1.12 rregullohen teknikisht dhe fjala „femra” zëvendësohet me „gruaja”

Amendamenti 4 - Deputeti Bekim Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 riformulohen si vijon :

1. Secilës grua të punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri i takojnë të gjitha të drejtat e garantuara me legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë.
2. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, nëse nuk e shfrytëzon pushimin e lehonisë pas muajit të gjashtë të tij dhe sipas dispozitave përkatëse ligjore në fuqi, prej muajit të gjashtë deri në një vit ka të drejtën e pushimit me pagesë në kohëzgjatje prej dy (2) orë në ditë brenda orarit të punës, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës, për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, siç është përcaktuar me këtë ligj.

Amendamenti 5 - Deputeti Bekim Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 5 , paragrafi 3 riformulohet si vijon :

3. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri pas vitit të parë deri në dy vjet ka të drejtën e një (1) orë në ditë pushim me pagesë brenda orarit të punës, për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës.

Amendamenti 6- Deputeti Bekim Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 5, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi i ri 4 si vijon :

4. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, nëse nuk dëshiron ta shfrytëzoj pushimin e lehonisë pas muajit të gjashtë deri në një vit, ka të drejtën e punës me gjysmë orari , me gjysmë pagese.

Çdo e punësuar që dëshiron ta shfrytëzoj pushimin e lehonisë pas muajit të gjashtë deri në një vit, me gjysmë orar, me gjysmë pagesë duhet ta njoftoi me shkrim punëdhënësin .

Amendamenti 7 - Deputeti Bekim Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 5, shtohet paragrafi i ri 5, si vijon :

5. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, pushimin me pagesë në kohëzgjatje prej (1) një apo dy (2) orë në ditë brenda orarit të punës, e shfrytëzon në fillim, në mes, apo përfundim të orarit të punës, në marrëveshje me punëdhënësin dhe për këtë e njofton me shkrim punëdhënësin bashkë me vërtetimin e mjekut se e punësuarja është në gjidhënjë.

Amendamenti 8

Neni 6, riformulohet si vijon :

Ndalesa absolute e ekspozimit

1. E punësuarja që ushqen foshnjën me qumësht gjiri nuk duhet, në asnjë rrethanë, të detyrohet të punojë në vende pune në të cilat i ekspozohet rrezikut për sigurinë ose shëndetin e saj dhe foshnjës së saj, të përcaktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Amendamenti 9

Në nenin 7, paragrafi 1, fjala „ maketohen “ zëvendësohet me „tregtohen“, si dhe në paragrafin 2. fjala „neni“ zëvendësohet me „ligji“

Amendamenti 10

Në nenin 7, paragrafi 3, fshihet fjalia „ 7.1.1. 7.2.6, paragrafi“.

Amendamenti 11

Në nenin 7, paragrafi 4, fjalia „ Çdo paketim dhe etiketë“ zëvendësohet me „, paketimi apo etiketa“

Amendamenti 12

Në nenin 7, paragrafin 4.6. pas lidhëzës „ose“ shtohet „ / dhe“.

Amendamenti 13

Në nenin 7, paragrafi 4.8. fshihet, gjithashtu në paragrafin 4.7, fshihet lidhëza „dhe “

Amendamenti 14

Në nenin 7, paragrafi 7, rregullohet teknikisht, ndërsa në paragrafin 7. lidhëza „dhe “ zëvendësohet me „, apo“ .

Amendamenti 15

Në nenin 7, paragrafi 7, nën-paragrafi 7.1.3. bëhet paragraf i ri 8, dhe në nën-paragrafin 7.1.4 fshihet fjalia „ gjatë procesit të prodhimit ose mund të kontaminohet“.

Amendamenti 16

Në nenin 7, paragrafi 7, nën-paragrafi 7.1.6 . pas fjalës „ qumështi “ shtohet fjala,, i përgatitur” dhe në nën-paragrafin 7.10 fjalia „ mund të ketë tendencën e dekurajimit “ zëvendësohet me „ dekurajon “.

Amendamenti 17

Në nenin 7, paragrafin 8.1; 8.2 ;8.3 si dhe në paragrafin 9.1. lidhëza „dhe “ zëvendësohet me „ apo”.

Amendamenti 18

Në nenin 7, nën- paragrafin 8.1.4. fshihet .

Amendamenti 19

Në neni 13, paragrafi 1, fjala „kryejnë” zëvendësohet me „mbikëqyrin”.

Amendamenti 20

Në nenin 13, nën-paragrafi 1.2. fshihet.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri votoj të gjitha amendamentet e propozuara nga grupi punues, përkrah edhe 3 amendamente të propozuara nga deputeti Bekim Haxhiu, ndërsa një nuk e përkrah me arsyetimin se ndërlidhët me Ligjin e punës. Raporti u procedua për shqyrtim te Komisionet Kryesore.

5. Të ndryshme.

Kryetarja – Tani grupi punues do të vazhdoj me amendamentimin e Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent , në mënyrë që edhe këtë Projektligj sa më shpejt ta amendamentojm, edhe pse Projektligji është shumë diskutabil dhe ka shumë probleme. Kemi pas edhe një takim me ministrin e shëndetësisë dhe grupin që ka hartuar Projektligjin dhe kemi vendosur që me gjithë mangësitë e Projektligjit, prapë se prapë do vazhdojmë me amendamentimin.

Komisioni vendosi që për grupin punues që do punoj në amendamentimin e Projektligjit të shtrohet drek pune.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA